



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2775/2 prot

Datë 10.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-79237-09-07-2023 me objekt **“Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti”** me fond limit 7,901,168.67 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24-10-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Medfau” SHPK Nipt J93610823R  
*Adresa: LAGJA 5, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.  
*Adresa: L.17 Rr. Dalip Peza*

Në datën 09.11.2023 , nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3585 dhe me nr. 2775/2023 prot., datë 09.11.2023 e operatorit “Medfau” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-79237-09-07-2023 me objekt “Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti” me fond limit 7,901,168.67 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24-10-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomike “Medfau” SHPK

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “Medfau” SHPK në ankesën nr. 2775/2023 datë 09.11.2023 , pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

*Opratori ekonomik nuk ka paraqitur katalog për artikujt numer 7, 13, 19, 20, 31, 33 dhe 35 në listen e artikujve të specifikimeve teknike të kerkuara ne piken 2.3.3 te kapacitetit teknik*

.Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 10.11.2023

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar  
Fiorent Zguro**